



DOKUMENTI I POLITIKAVE TË
SIGURISË
2017

**KOMISIONI KOMBËTAR I
EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR
(K.K.E.K.SH)**



PËRMBAJTJA

- I. Përkufizimi i Termave***
- II. Fusha e veprimit dhe zbatueshmëria***
- III. Qëllimi dhe misioni i K.K.E.K.SH***
- IV. Parimet themelore***
- V. Punësimi i Stafit***
- VI. Përgjegjësia e Stafit dhe Etika***
- VII. Trajnimi i Stafit***
- VIII. Kushtet e Sigurisë së Punës***
- IX. Ankesat kundër anëtarëve të stafit***
- X. Struktura e Mbrojtjes së K.K.E.K.SH***
- XI. Monitorimi***
- XII. Dispozitat Përfundimtare***

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Policies and Procedures Reference No.	S.P 01
Policy Title	Policy on Child Safeguarding (“Child Safeguarding Policy”) and Vulnerable Adults
Category	Child Safeguarding & Vulnerable Adults
Author	The Secretariat of KKEKSH
Approver	The Leading Council and The Commission for the Catholic Education (KKEKSH)
Purpose and Description	These policies and related procedures describe KKEKSH commitment to child safeguarding and vulnerable adults.
Effective date	December 14, 2017
Revision date	December 14 , 2018

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale”



I. Përkufizimi i Termave

Fëmijë - është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Adoleshent - një djalë ose një vajzë i/e moshës 14-18 vjeç.

Person vulnerabël : i referohet një personi 18 vjeç e sipër, i cili për shkak të aftësisë së kufizuar, moshës ose sëmundjeve, konteksti në të cilin ndodhen ose si pasojë e pabarazive sociale dhe të tjera, është ose mund të mos jetë në gjendje të kujdeset ose të mbrohet nga një dëm i konsiderueshëm ose shfrytëzim i mundshëm.

Stafi - të gjithë individët, të cilët janë punonjës ose vullnetarë me kohë të plotë ose me orar të pjesshëm të KKEKSH.

Vullnetar - një individ i cili përfshihet në kohën e tij të lirë në aktivitete të ndryshme të organizuar nga KKEKSH me kontratë të rregullt vullnetariati .

Dhunë ndaj fëmijës - është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

Diskriminimi: është çdo përjashtim, kufizim apo preference që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët , të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, si dhe me ligjet në fuqi.

Abuzimi – është një dëm (fizik, psikologjik apo seksual), keqtrajtimi, abuzimi, neglizhimi ose privimi i çdo fëmijë apo të riu.

a) Abuzimi psikologjik i fëmijëve përfshin një sjellje të tillë nga ana e një personi, që ka një pasojë negative për zhvillimin psikologjik, emocional dhe sjelljen e fëmijës.

Nga abuzimi psikologjik, ne nënkuptojmë dëmtime të përsëritura ndaj një fëmije nga prindërit ose persona të tjerë duke e refuzuar në mënyrë të përsëritur fëmijën, duke e poshtëruar, frikësuar, duke kufizuar lirinë e tij, lëvizjen dhe kontaktin me mjedisin, duke i mësuar fëmijët me mendime dhe mënyrat e sjelljes në kundërshtim me moralin e shoqërisë.

Bullizmi - Është një formë sjellje agresive i një fëmije ose i një grupi fëmijësh kundrejt fëmijëve të tjerë, sjellje e cila përsëritet në mënyrë të vazhdueshme – zakonisht ndaj dikujt që shpesh shihet si më i dobëti ose që ka më pak fuqi /forcë.

b) Abuzimi trupor (fizik) i një personi të mitur është një veprim i dhunshëm dhe i qëllimshëm nga ana e prindit ose personave të tjerë, që rezultojnë me vuajtje fizike, dëmtim të shëndetit, dëmtim fizik, ose mos-parandalimi i ndërjegjshëm i abuzimit fizik të fëmijës nga një person tjetër. Përgjegjësia për abuzimin e fëmijëve qëndron tek personi i cili është dëshmitar i abuzimit dhe nuk e parandalon atë ose një person i cili është përgjegjës për një fëmijë, me vetëdije të plotë ose me pakujdesi dështon në parandalimin e lëndimeve aksidentale ose dëmtimin e shëndetit të fëmijës.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



c) **Abuzimi seksual** - Abuzimi seksual përfshin çdo marrëdhënie seksuale, ose shfrytëzim seksual i një fëmije nga kushdo, të cilit i është besuar fëmija, ose nga kushdo që ka ardhur në çdo kontakt me fëmijën. Abuzimi seksual i të miturve përfshin edhe pjesëmarrjen e të miturve në ekspozim të pahijshëm, duke bërë video pornografike, fotografi dhe audio.

II. Qëllimi dhe Misioni i KKEKSH

Qëllimi i këtij Enti (KKEKSH) është fetar, formues – edukues, dhe jofitimprurës referuar kan.800/1, kan 803 dhe 804/1 të Kodit të së Drejtës Kanonike (CIC). Natyra e këtij enti është baritore me natyrë edukuese. Ky Ent kishtar zhvillon kryesisht aktivitetet (veprimtari) fetare, si dhe formuese – edukuese të cilat konsistojnë sa më poshtë :

- të promovojë përmbushjen me efektivitet të lirisë së arsimit si një kusht themelor për funksionimin e një shoqërie demokratike, në përputhje me të drejtat e liritë themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Deklarata, Konventa dhe protokollat shtesë të ratifikuara nga shteti shqiptar.
- të mbështesë, informojë, azhurnojë shkollat apo institucionet të drejtuara dhe të administruara nga Entet e Kishës Katolike, duke i mbështetur me konsulencë të natyrës didaktike, juridike, ekonomike-fiskale, si dhe mbi ndryshimet legjislative që mund t'i interesojnë këtyre institucioneve të arsimit lidhur me problematikat dhe zgjidhjen e situatave të krijuara

III. Fusha e veprimit dhe zbatueshmëria

Dokumenti i Politikave të Sigurisë (D.P.S) rregullon politikën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rriturve vulnerabël që janë subjekt i KKEKSH në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ka për qëllim të shtrijë efektet e saj në të gjithë rrjetin e institucioneve edukative që KKEKSH mbulon .Qëllimi i (DPS) është të përcaktojë termat bazë dhe mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve vulnerabël, përgjegjësinë e stafit mbikëqyrës, procedurat në rastet e konflikteve të mundshme që hasen në ambientet edukative si dhe rolin e përfaqësuesit të mbrojtjes së fëmijëve që të garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

KKEKSH synon dhe nxit nëpërmjet këtij dokumenti respektimin e politikave të mbrojtjes nga stafi, anëtarët apo bashkëpunëtorët e tij sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi si dhe vënien në zbatim të tyre.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



A.POLITIKAT

IV. PARIMET THEMELORE

Politika e mbrojtjes së fëmijëve bazohet në parimet e mëposhtme :

1. Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta të barabarta. Asnjë fëmijë apo i ri, nuk duhet të dëmtohet për shkak të gjinisë, ngjyrës, gjuhës apo besimit të tij.
2. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e informimit, shprehjes së mendimit të tyre dhe të drejtën për t'u dëgjuar.
3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën apo zhvillimin e tij normal.
4. Interesat më të larta të çdo fëmije duhen mbrojtur me çdo kusht, duke përfshirë edhe përkrahjen për çështjet e fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të tyre.
5. Parimi themelor i punës me fëmijët është që fëmijët duhet të jenë në gjendje të ndjehen të sigurt. Mirëqenia dhe interesi më i lartë i tyre është përparësia jonë kryesore.

KKEKSH parashikon:

1.Politika mbi angazhimin ndaj fëmijëve

Në mbështetje të kësaj politike Angazhimi duhet të jetë i bazuar mbi mekanizma që promovojnë :

- a) **Parandalimin e abuzimit të fëmijëve :** Përpjekja, nëpërmjet vetëdijes, praktikës së mirë dhe trajnimit,për të minimizuar rreziqet ndaj fëmijëve dhe për të marrë hapa pozitivë për të ndihmuar në mbrojtjen e fëmijëve nëse janë viktimë e ndonjë abuzimi të mundshëm.
- b) **Raportimin e Abuzimit të Fëmijëve:** Sigurimi që të gjithë Përgjegjësit e Politikës së Sigurisë (P.P.S) në shkolla, të dinë hapat që duhen marrë dhe kë të kontaktojnë kur lindin shqetësime në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.
- c) **Duke iu përgjigjur abuzimit të fëmijëve:** Angazhimi në veprim si nga Përfaqësuesi për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) i KKEKSH ashtu dhe Përgjegjësi i Politikës së Sigurisë së shkollës, që të mbështesin dhe mbrojnë fëmijët kur lindin shqetësime në lidhje me mirëqenien e tyre dhe marrjen masave të përshtatshme për të parandaluar përsëritjen e një rasti të tillë.
- d) **Trajnime për Promovimin e Ndërgjegjësimit Për Mbrojtjen e Fëmijëve :** Sigurimi që të gjithë Përfaqësuesit (PMF dhe PPS) të jenë të vetëdijshëm , dhe të veprojnë në përputhje me dokumentin e politikës së sigurisë.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



2. Politika në respektim me ligjet dhe rregulloret në fuqi

Kjo politikë duhet të jetë e bazuar mbi legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve, standardet ndërkombëtare, si dhe cdo dispozitë tjetër që parashikon dhe mbron fushën e së drejtës së fëmijëve.

3. Politika për Përgjegjshmërinë e Menaxhimit

Përfaqësuesi Për Mbrojtjen e Fëmijëve i KKEKSH, është i angazhuar për të ndërmarrë të gjitha masat e duhura korrigjuese, disiplinore, ligjore ose veprime të tjera në përgjigje të çfarëdo lloj shkeljeje të politikave për Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shqyrtuar politikën, procedurat dhe protokollet e aplikueshme në identifikimin dhe adresimin e boshllëqeve ose dobësive gjatë raportimit të rastit.

4. Politika mbi konfidencialitetin në çështjet e mbrojtjes së fëmijës

KKEKSH ka për detyrë që të menaxhojë informatat sensitive në një mënyrë konfidenciale, profesionale dhe në përputhje me ligjin në fuqi¹. Stafit duhet të mbajë të gjithë informacionin për incidentet lidhur me ndonjë të dyshuar ose të raportuar, në mënyrë strikte e konfidenciale si dhe duhet ta bashkëndajë këtë informacion vetëm tek Përgjegjësi i Politikave të Sigurisë ose tek Përfaqësuesi Për Mbrojtjen e Fëmijës. (shtojca 1)

B. PEOPLE

V. Punësimi i Stafit

KKEKSH, për të siguruar një qëndrim të besueshëm dhe profesional të stafit të tij i cili është në marrëdhënie të vazhdueshme me institucionet arsimore/edukative formale dhe jo formale të Kishës, të cilët çdo ditë janë në kontakt me persona vulnerabël (kryesisht fëmijë dhe të rinj), përcakton parimet dhe kriteret e mëposhtme për punësimin e stafit të tij.

Kriteret e punësimit:

1. KKEKSH, (Presidenti) shpall karakteristikat profesionale të vendit vakant të punës ose të shërbimit vullnetar.
2. Pranon brenda një afati kohor kërkesat e kandidatëve bashkë me dokumentacionin bazë:
 - Letra Motivuese dhe CV
 - Kartë identiteti
 - Dëshmi penaliteti
 - Përgatitja profesionale (Diploma përkatëse)
 - Gjëndjen shëndetësore

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



3. Shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin e kandidatit dhe merr informata paraprake, thërret në intervistë kandidatin.
4. Sigurohet që kandidati të jetë një person me përvojë i cili respekton parimet e KKEKSH dhe garanton mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve vulnerabël në fushën e edukimit.
5. Sigurohet që ka kuptuar mirë rëndësinë dhe përmbajtjen e Vetëdeklarimit.
6. I kërkon kandidatit plotësimin e dokumentacionit origjinal, firmosjen e kontratës konform ligjit në fuqi (**shtojca 6**), firmosjen e Dokumentit të Politikës së Sigurisë (D.P.S), si dhe firmosjen e vetëdeklarimit ku parashtrihen parimet themelore të KKEKSH. (**shtojca nr.1**)

Proçedura e dokumentimit nga intervista e kryer për punë e kandidatit të mundshëm, arkivohet në dosjen personale të punonjësit dhe ruhet sipas dispozitave të ligjit.

VI. Përgjegjësia e Stafit dhe Etika

Qëndrimi etik i Personelit konsiston në:

- njohjen dhe respektimin e (D.P.S), në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, dhe të tjerë dokumente referuese të parashikuara me ligj;
- njohjen dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe të drejtave të fëmijës ;
- mbajtjen e kufijve profesionalë dhe të evitimin e sjelljeve që mund të keqinterpretohen nga të tjerët;
- respektimin e secilës figurë mbështetëse në besimin e tij fetar, përkatësinë etnike, dallimet sociale etj.
- marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me ligjet në fuqi;
- ruajtjen e konfidencialitetit të fakteve dhe të dhënave gjatë situatave të ndryshme të dokumentuara në punën e tyre, veçanërisht nëse i është besuar një e dhënë e një fëmije dhe dokumenti kërkon konfidencialitet.
- sigurimin e një qëndrueshmërie të sjelljes në marrëdhënie me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël , si dhe të ketë njohuri mbi treguesit e neglizhencës.

Çdo anëtar i stafit ka përgjegjësi :

- për çdo sinjalizim, shqetësim, dyshim apo pretendim për abuzim në këtë fushë, që mund të vijë nga një institucion edukativ arsimor i rrjetit që mbulon.
- për të sinjalizuar në mënyrë konfidenciale çdo raportim të ardhur në mënyrë anonime dhe ta bashkëndajë atë me personin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Në këto raste çdo anëtar i stafit duhet të raportojë së pari tek Përfaqësuesi i Mbrojtjes së Fëmijëve të Komisionit (KKEKSH) dhe në rast të konstatimit të drejtpërdrejtë (në raste vizitash në Institucione) të jetë vigjilent në lidhje me këtë aspekt dhe ka detyrë të informojë Përgjegjësën e Politikave të Sigurisë të institucionit përkatës i cili konsultohet me Këshillin e Vigjilencës për ndjekjen dhe zgjidhjen e situatës.

Asnjë shqetësim, dyshim apo pretendim rreth një abuzimi të supozuar ose të raportuar drejtëpërsëdrejti apo në mënyrë anonime, nuk mund të anashkalohet nga asnjë prej anëtarëve të stafit, por të ndiqet seriozisht deri në marrjen e masave mbrojtëse ose parandaluese.

Nëse agjensitë ligjzbatuese vendosin të ndërmarrin hapat e nevojshëm proceduralë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në nivel vendor si NJMF-të (Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve) e cila ka për detyrë të identifikojë dhe menaxhojë rastet e fëmijëve në rrezik që ndodhen brenda zonës ku kjo njësi shtrin juridiksionin e saj, **detyra e stafit** është të sigurojë një bashkëpunim sa më efikas me organet kompetente për zbardhjen e çështjes si dhe dhënien e dëshmive apo çdo të dhëne tjetër që është në interesin më të lartë të fëmijës.

NUK është detyrë e stafit të hetojë pretendimet për abuzimin e fëmijëve që mund të vijnë nga ndonjë institucion edukativ të cilat mund t'i konstatojë në raste vizitash konkrete në institucionet edukative të rrjetit që KKEKSH mbulon.

VII. Kushtet e Sigurisë së Punës

Kushtet e sigurisë së punës konsiderohen si një vlerë parësore nga KKEKSH i cili është i detyruar të aplikojë masat e nevojshme për të mbrojtur integritetin fizik dhe personalitetin moral të punonjësve të tij.

Çdo lidhje interneti që mund të vihet në dispozicion (telefon, faks, e-mail, dhe regjistruarit e videove), duhet të përdoren për kohën e domosdoshme dhe vetëm për qëllimin e punës si dhe gjatë kryerjes së aktiviteteve arsimore dhe sociale.

Punonjësit që kanë akses në rrjetin e brendshëm ose në postën elektronike nuk iu lejohe të:

- shkarkojnë programe softëare, fotografi, mbajtjen e dosjeve në rrjetin e brendshëm të cilat nuk lidhen me qëllimin e punës;
- të përdorin për arsye personale file të sistemit ose të postës elektronike që kanë të bëjnë me minorenët;
- të përdorin postën elektronike dhe internetin për blerje ose shitje online për qëllime vetjake.
- nuk mund të proçedojnë drejtpërdrejtë në kompjuterin personal të programeve ose të publikojnë apo të heqin programe të instaluar përveç nëse autorizohet shprehimisht nga drejtuesi i institucionit.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



- Anëtarët e stafit dhe bashkëpunëtorë të tjerë janë të ndaluar të fusin në çdo formë fletushka, pyetësorë, printime, imazhe, materiale multimediale apo të ngjashme, pa lejen paraprake të personit të autorizuar nga enti, si dhe lidhjet telematike me të miturit e shërbime të tjera pa lejen paraprake me shkrim nga cilitdo që është i autorizuar.

Për mbrojtjen dhe mirëqenien më të mirë të fëmijëve, identifikimi i tyre në të dhëna personale, (emri, adresa, shkolla, etj.) nuk duhet të përdoren dhe publikohen pa miratimin prindërve ose të personave të autorizuar.

VIII. Trajnimi i Stafit

KKEKSH merr përsipër që çdo anëtar i stafit që është në kontakt direkt ose indirekt me personelin dhe në raste të veçanta me fëmijët dhe të rinjtë, duhet të jetë në gjendje të promovojë e sigurojë interesat e tyre më të mira.

Secili anëtar i stafit do të trajnohet në mënyrë profesionale edhe mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve vulnerabël në një nivel të përshtatshëm për rolin e tyre. KKEKSH përfshin:

-Trajnimet për Mbrojtjen e Fëmijëve, duke përfshirë sistemet e ndërgjegjësimit dhe raportimit, i cili do të sigurohet në baza vjetore, (kjo përfshin kurse vjetore për stafin që kanë qenë të punësuar më shumë se 1 vit);

-Të gjithë stafit të ri do t'u jepen udhëzime për politikën e mbrojtjes së fëmijëve si pjesë e orientimit të tyre të punës. Udhëzimet do kenë një kohë të caktuar në varësi të rolit që ka anëtari i stafit, por në çdo rast do të jetë një afat brenda 3 muajve nga fillimi i punësimit ose para mbarimit të periudhës së provës;

- Të gjithë stafit iu sigurohet aksesimi në të gjitha procedurat dhe politikën e shkruara që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe personave vulnerabël.

Stafi njihet me: Procedurat e Përgjithshme të Mbrojtjes së Fëmijëve të Institucioneve Shkollore dhe me azhurnimet e tij. (shtojca nr 5)

Përfaqësuesi i mbrojtjes së fëmijëve do t'i nënshtrohet një trajnimit më intensiv lidhur me mbrojtjen e fëmijës.

Koordinatori Kombëtar i KKEKSH është përgjegjës për zhvillimin profesional të stafit dhe anëtarëve të tij të paktën 1 herë në vit.

IX. Ankesat ndaj anëtarëve të stafit

Ky paragraf përcakton procedurat që duhet të ndiqen nëse një individ, institucion i rrjetit apo të tretë kanë bërë ankesë ndaj sjelljeve të papërshtatshme të një anëtari të stafit në lidhje me abuzime apo neglizhenca të mundshme.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Dyshimet e shprehura në konfidencialitet në K.V (Këshilli Vigjilencës) trajtohen me delikatesë e profesionalizëm në përputhje me etikën e institucionit.

Ankesat dhe dyshimet që mund të lindin për abuzimin ndaj një anëtari të personelit duhet të merren seriozisht dhe të raportohen tek personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve,(P.M.F ose P.P.S) me përgjegjësi dhe në përputhje të plotë me këtë dokument.Përfaqësuesi Për mbrojtjen e Fëmijës pasi është njohur me rastin e paraqitur , menjëherë konsultohet me Këshillin e Vigjilencës lidhur me vlerësimin e rrezikut deri në marrjen e masave parandaluese për zgjidhjen e situates ,duke ndjekur hapat e nevojshem proceduralë në përputhje me kerkesat ligjore dhe trajtimin e rastit abuziv per shqyrtim pranë organeve kompetente.

Ankesa duhet të jetë e dokumentuar në formë të përshtatshme (me shkrim ose me gojë) ose mund të paraqitet në formë anonime.

Ankesat mund të jenë për shfaqje neglizhence ndaj rasteve të raportuara si;

- në raste dyshimi të formave të ndryshme të abuzimit direkt,
- në raste dyshimi të dhunës psikologjike/seksuale apo çdo forme tjetër abuzimi ndaj fëmijës apo një të rrituri vulnerabël brënda mjedisit shkollor/edukativ;
- në raste paraqitjeje të papërshtatshme ose poshtëruese të imazheve apo materialeve të tjera vizive, që çenojnë të dhënat personale të stafit apo të miturve;
- në raste të hapjes dhe frekuentimit të faqeve të web-it që kanë materiale pornografike dhe këmbimi i tyre në ambientet e punës etj.

Ankesat ndiqen seriozisht edhe kur rastet e mësipërme ndodhin në ambiente jashtë punës.

C.PROÇEDURAT

X. Struktura e Mbrojtjes së KKEKSH

Struktura e KKEKSH funksionon në kuadër të mbrojtjes dhe sigurisë së fëmijëve e të rriturve vulnerabël e cila përbëhet nga :

Këshilli i Vigjilencës (KV)

1. Imzot Angelo Massafra (Presidenti) Përfaqësuesi Ligjor KKEKSH
2. Motër Teuta Buka Koordinatori Kombëtar (KKEKSH)
3. Av.Malvina Përgega Përfaqësuese për Mbrojtjen e Fëmijëve (KKEKSH)

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Përfaqësuesi për Mbrojtjen e Fëmijëve informon Këshillin e Vigjilencës për çdo rast të konstatuar ose të raportuar nga stafi apo entet arsimore edukative si dhe këshillohet me të për ndjekjen e procedurave të nevojshme që duhen ndërmarrë në zgjidhjen sa më efektive të situatës së paraqitur.

Procedura e ndjekur nga Përfaqësuesi Për Mbrojtjen e Fëmijës :

- Të nxisë hartimin e një dokumenti të politikave të sigurisë (**D.P.S**) për rrjetin e shkollave katolike;
- Të sigurohet që Dokumenti i Politikave të Sigurisë (**D.P.S**) të KKEKSH të zbatohet në praktikë në çdo shkollë të rrjetit në kuadër të problematikave referuese të paraqitura;
- Të sigurohet që ka një person përgjegjës të politikave të sigurisë dhe një Këshill Vigjilence në çdo shkollë të rrjetit të cilët kanë përgjegjësinë për trajtimin dhe marrjen e hapave të menjëhershëm ndaj rasteve abuzive;
- Të jetë pika e parë e kontaktit në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, të konstatuara dhe të raportuara këto drejtpërsëdrejti nga Përgjegjësi i Politikave të Sigurisë së shkollës apo enteve edukative;
- Të kontaktojë personin përgjegjës të politikave të sigurisë (P.P.S) të shkollës përkatëse, dhe të marrë informacionin e duhur në rastet kur çështja ka marrë përmasa të një trajte më të gjerë e të pazgjydhshme, në mënyrë të tillë që ky informacion të japë detaje specifike që ndihmojnë në lehtësimin e hapave dhe procedurave të mëtejshme që do ndërmerren për zbardhjen e çështjes në bashkëpunim me organet kompetente të ligjit;
- Të koordinohet me personin përgjegjës të politikave të sigurisë (P.P.S) të shkollës përkatëse , stafin përgjegjës si dhe me Këshillin e Vigjilencës, për garantimin dhe zbatimin e procedurave që parashikon (D.P.S) Dokumenti i Politikave të Sigurisë i hartuar nga vetë shkolla;
- Të kontaktojë strukturat e mbrojtjes sociale-ligjore të fëmijëve, si dhe autoritetet e zbatimit të ligjit nëse është e nevojshme.

Nëse Përfaqësuesi i Mbrojtjes së Fëmijëve nuk është i pranishëm në vend, mund të veprojë si zëvendës përfaqësues i mbrojtjes së fëmijëve për rastin e paraqitur Këshilli i Vigjilencës .

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"





Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

ORGANIGRAMA K.K.E.K.SH

STRUKTURA E MBROJTJES K.K.E.K.SH

**D. MONITORIMI****X.Monitorimi****a. Rregullat për të monitoruar procedurat e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rriturve të tjerë vulnerabël në përputhshmëri të plotë me Dokumentin e Politikave të Sigurisë (D.P.S):**

- T'u kërkojë institucioneve edukative të rrjetit DPS e tyre.
- Të sugjerojë pasqyrimin në DPS-të e shkollave, përgjegjësitë dhe procedurat për rastet e incidenteve, abuzimeve apo neglizhencave të mundshme.
- Të monitorojë dokumentimin e ankesave apo çdo pretendim tjetër për abuzim të adresuar në formë anonime .
- Të sigurojë dhe suportojë Këshillin e Vigjilencës së shkollave në zgjidhjen e cdo rasti.
- Të stimulojë azhornimin e DPS sipas afateve kohore së çdo shkolle të paktën një herë në vit.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



1. Vlerësimi dhe interpretimi i informacionit

Këshilli i Vigjilencës nëpërmjet Përfaqësuesit për mbrojtjen e fëmijës dhe personave vulnerabël, verifikon zbatimin e praktikave të politikës së mbrojtjes (D.P.S) të KKEKSH dhe të Shkollave e Enteve Edukative të rrjetit që mbulon, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të performancës së stafit dhe garanton kontaktin periodik dy mujor si dhe vlerëson rast pas rasti rreziqet e dyshuara ose të konstatuara. Këshilli i Vigjilencës nxit fuqizimin e politikave të sigurisë për mbrojtjen e fëmijëve dhe personave vulnerabël. Këshilli i Vigjilencës mblidhet 1 herë në 6 muaj për analizimin e ecurisë së punës dhe shqyrtimin e problematikave të rasteve të paraqitura të cilat kanë ngelur pezull ose për të cilat nuk janë ndjekur hapat e duhur proceduralë.

a. Vlerësimi i rrezikut ndihmon në minimizimin e abuzimit të mundshëm të fëmijëve dhe adoleshentëve.

- PMF (Përfaqësuesi i Mbrojtjes së Fëmijëve) i kërkohet :
 - ✓ të rivlerësojë rreziqet në bazë të informacionit të dhënë nga Institucionet Edukative ose të konstatuara direkt nga (P.P.S).
 - ✓ të marrë masa për të parandaluar mundësinë dhe situatat që mund të rezultojnë të dëmshme për fëmijët dhe adoleshentët.

Procedurat e vlerësimit të rreziqeve:

- 1) Mbledhja e informacionit nëpërmjet Përgjegjësit të Politikave të Sigurisë (P.P.S)
- 2) Identifikimi i rreziqeve nëpërmjet Këshillit të Vigjilencës dhe Përgjegjësit të Politikave të Sigurisë (P.P.S)
- 3) Vlerësimi i rreziqeve (vlerësimi analizohet sipas nivelit të rrezikut)
- 4) Planifikimi i hapave që do ndërmerren për eliminimin ose kufizimin e rreziqeve.
- 5) Ndjekja e hapave dhe përcaktimi i afateve për shqyrtim.
- 6) Rivlerësimi dhe marrja e masave konkrete.
- 5) Ruajtja e dokumentacionit të vlerësimit të rrezikut .

b. Parimet e vlerësimit të rrezikut

✓ Sjellja Etike

Monitorimi/ mbikëqyrja duhet të jetë e bazuar parimisht në besim, integritet, konfidencialitet dhe siguri të plotë.

✓ Prezantimi i paanshëm

Prezantimi me transparencë dhe në mënyrë të paanshme të rezultateve dhe konkluzioneve të raporteve të kontrollit, duke sjellë në vëmendje pengesat më të mëdha që hasen gjatë monitorimit si dhe situatat e pazgjidhura ndërmjet ekipit monitorues dhe Entitetit të monitoruar.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

✓ **Profesionalizëm i duhur**

Monitoruesit, **përmbajtjen e raportit të kontrollit** ta bazojnë mbi njohuritë profesionale të integruara si dhe mbi bazën e informacionit të regjistruar.

✓ **Pavarësia**

Monitoruesit duhet të ruajnë një qëndrim të pavarur të njëanshëm dhe objektiv të mendimeve /përshtypjeve gjatë procesit të monitorimit për të siguruar që rezultatet dhe konkluzionet e monitorimit të bazohen vetëm në evidencën e auditimit/mbikëqyrëse.

XII. Dispozitat përfundimtare

Çdo shkelje e parimeve apo çdo sjellje e punonjësve që bie në kundërshtim me dispozitat e Dokumentit të Politikës së Sigurisë për mbrojtjen e fëmijëve e të rriturve vulnerabël, do të jetë shkak për hetim me pezullim /shkarkim të mundshëm nga KKEKSH në pajtim me dispozitat e Kodit të Punës në fuqi dhe Rregullores së Brendshme të Komisionit Kombëtar për Edukimin Katolik Shqiptar.

Nëse lindin mosmarrëveshje ndërmjet palëve, ato do të zgjidhen duke zbatuar parimin e mirëkuptimit. Nëse një gjë e tillë nuk arrihet, kompetente për këtë do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi tjetër ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim.

Tiranë, 2017

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

SHTOJCA 1

DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Objekti

Kjo deklaratë i drejtohet të gjithë stafit të KKEKSH, si dhe punonjësve të përkohshëm, vullnetarëve dhe palëve të tjera të cilët kanë akses në informacionin e mbajtur nga KKEKSH.

Ajo përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë akses në informacione të tilla dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

Fusha e veprimit

Fushëveprimi i kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat personale dhe informacione konfidenciale që njihen gjatë punës në KKEKSH. Dispozitat përkatëse zbatohen edhe pasi marrëdhënia e punës me KKEKSH ka përfunduar. Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga të gjithë ata punonjës të cilët kanë akses në të dhënat personale të KKEKSH.

Deklarata e konfidencialitetit

1. Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor dhe të mos i transmetoj personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga KKEKSH, përveç nëse autorizohem shprehimisht nga KKEKSH, ose kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të punësimit si dhe pas përfundimit të tij.
2. Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga Ligji nr.9987, datë 10.03.2008 për “Mbrotjtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë personale që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.
3. Unë e kuptoj se jam i detyruar të ruaj konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t’i mbaj ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.
4. Marr përgjegjësinë e plotë që në qoftë se konstatohet që kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale, apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të mbajtur standarte të larta profesionale në KKEKSH.

Firma e të Punësuarit

Firma e Eprorit

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Per Mbrotjtjen e te Dhenave Personale”



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

SHTOJCA .2

FORMULARI I ANKIMIT NDAJ STAFIT

Data:

KKEKSH do e trajtojë informacionin tuaj në mënyrë konfidenciale. Megjithatë ju duhet të merrni në konsideratë se nëse ankesa juaj lidhet me një person apo persona të tjerë, stafi i ngarkuar në trajtimin e ankesës tuaj duhet ta zbulojë ankesën tuaj dhe detaje të saj tek personi/nat e paditur prej jush, me qëllim që të marre një përgjigje edhe prej tyre.

Informacion personal

Emri Mbiemri
Pozicioni/detyra

Kontakte
Tel:
Email:

Informacion rreth ankesës

PO JO

Ankesa juaj është ndaj një personi tjetër

Nese PO, identifikoni personin me emër dhe mbiemër dhe detyrën që mban:

Ju lutem, ofroni përshkrim dhe detaje rreth ankeses tuaj: jepni informacion sa më shumë të jetë mundur duke shpjeguar se çfare ndodhi, kur (datën dhe orën), kush ishte i pranishëm, etj.

Cfare ndikimi ka kjo tek ju:

A ka ndodhur kjo gjë edhe me
pare:

PO JO

Nese PO, jepni detaje:

Informacion rreth procesit të ankimimit

(Çfare rezultatesh apo masash, pretendoni ju në përfundim të ankesës tuaj)

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Cila është metoda juaj e preferuar në trajtimin e ankesës tuaj ?

Proçedurë joformale

Proçedurë Formale/zyrtare

A keni ndërmarrë ndonjë veprim për ta zgjidhur ankesën tuaj? PO JO

Nese PO, a mund të pershkruani veprimet që keni bërë deri tani, për zgjidhjen e ankesës tuaj?

Informacion tjetër

A keni informacion tjetër që dëshironi ta përmendni apo përfshini në ankesën tuaj

Emër Mbiemër

Nënshkrimi i ankuesit

(Përfaqësuesi Për Mbrojtjen e Fëmijëve ose Përgjegjësi i Politikave të Sigurisë)

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

SHTOJCA 3

Forma e raportimit të incidentit për mbrojtjen e fëmijëve

Data e Raportit:

Vendi:

I raportuar nga:

Emri juaj:

Pozicioni juaj:

Numri i telefonit tuaj:

Adresa juaj e emailit:

Personi që mbrohet (viktima)

Emri:

Emri i familjes:

Data e lindjes:

Gjinia:

Kombësia:

Adresa dhe detajet e kontaktit:

Me kë banon fëmija?

A janë përfshirë fëmijët e tjerë?

Personi që shkaktoi problemin (shkelësi)

Emri i familjes:

Emri:

Mosha:

Gjinia:

Kombësia:

Adresa dhe detajet e kontaktit:

Cila është marrëdhënia e këtij personi me fëmijën?

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Nëse ka dy ose më shumë njerëz që kanë shkaktuar këtë problem, ju lutemi shtoni detaje në fund të këtij raporti

Faktet (detajet e incidentit / raportit)

Data e incidentit:

Koha e incidentit:

Vendndodhja e incidentit:

Si jeni bërë të vetëdijshëm për incidentin?

Kam dëshmuar atë Stafi tjetër më tregoi me tregoi viktima Tjetër (specifiko)

A kishte ndonjë dëshmitar tjetër për incidentin? Po Jo

Nëse po, ju lutemi jepni emrin, pozicionin dhe detajet e kontaktit:

Ju lutem përshkruani incidentin e veçantë të abuzimit të fëmijëve:

Mbrojtja

Çfarë veprimi i menjëhershëm është ndërmarrë për të mbrojtur fëmijën?

Emër Mbiemër

Nënshkrimi i ankuesit

(Përfaqësuesi Për Mbrojtjen e Fëmijëve
ose Përgjegjësi i Politikave të Sigurisë)

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

SHTOJCA .4

Formulari i raportit dhe planit individual për mbrojtjen e fëmijës

Takimi për mbrojtjen e Fëmijës		
Emri i fëmijës :		
Mosha dhe datëlindja e fëmijës :		
Data:		
Pjesëmarrësit e pranishëm në Takimin për Mbrojtjen e Fëmijës		
Emri/Mbiemri	Institucioni/Pozicioni	Detajet e kontaktit
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		
Shqetësime për fëmijën që paraqiten nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijeve (KKEKSH) ose Përgjegjësi i Politikave të Sigurisë së shkollës		
Informacioni i paraqitur nga pjesëmarrësit (në lidhje me fëmijën dhe situatën e tij/saj familjare)		

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale”



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Vendimi i takimit për Mbrojtjen e Fëmijës nga Këshilli i Vigjilencës		
Fëmija kërkon shërbime mbrojtëse	PO	JO
Lloji i Rrezikut :		
Niveli i rrezikut:		

Masat lehtësuese për Mbrojtjen e Fëmijës	Periudha nga :	Deri me :
--	----------------	-----------

Lloji i Rrezikut	Niveli i Rrezikut	Veprimi i ndërmarrë	Afati kohor

<p>Data e Takimit të Shqyrtimit për Mbrojtjen e Fëmijës</p> <p>Firma e Punonjësit/Përgjegjësit të rastit të fëmijës: _____</p> <p>Firma e anëtarëve të Këshillit të Vigjilencës: _____</p>
--

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

SHTOJCA 5

Procedurat e Përgjithshme të Mbrojtjes së Fëmijëve të Institucioneve Shkollore

Ky paragraf përshkruan një udhëzues orientues për stafin që t'i përgjigjet shqetësimeve rreth abuzimit të fëmijëve.

Personi përgjegjës i politikave të sigurisë që shkolla, institucioni edukativ ka caktuar, që është në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët dhe persona të tjerë vulnerabël apo dhe me vetë stafin, kur i raportohet një rast i dyshuar abuzimi neglizhimi apo keqtrajtimi, duhet të ndjekë menjëherë procedurat e përcaktuara të mbrojtjes dhe udhëzimet për raportim për rastin e konstatuar/raportuar. Ai e trajton atë në bashkëpunim me Këshillin e Vigjilencës të shkollës në mënyrë të tillë që të përcaktohet vlerësimi i rrezikut të shkaktuar dhe marrja e masave parandaluese me organet hetimore konform ligjit .

Nëse rasti i konstatuar nuk paraqet rrezikshmëri të lartë, ky i fundit mund të zgjidhet dhe nga vetë Institucioni Shkollor nëpërmjet Komisionit të Vigjilencës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe personave vulnerabël.

Ai vepron vetëm me personat përgjegjës për bashkëndarjen e informacionit konfidencial të Këshillit të Vigjilencës së Shkollës, me drejtuesin përkatës, si dhe në rast nevojë konsultohet me Përfaqësuesin e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) dhe me Këshillin e Vigjilencës të KKEKSH .

Prandaj çdo dyshim ose raport i dhunës, apo abuzimit seksual duhet të merret me përgjegjësi të plotë dhe në formë të dokumentuar dhe të hetohet nga organet përkatëse. Të gjitha të dhënat e formularëve apo të raporteve të plotësuar ruhen në një skedar të veçantë në një kuti të mbyllur.

P.S.

(Firmoset bashkë me shtojcën 3 dhe 4)

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

SHTOJCA 6 MODEL KONTRATE**Tiranë, me _____ -****KONTRATË PUNE**

Kjo kontratë pune lidhet sot më datë _____ ndërmjet Komisionit Kombëtar për Edukimin Katolik Shqiptar, regjistruar si person juridik me Vendimin nr.5603 date 24.05.2017 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, me NIPT: L71816452E, me përfaqësues ligjor të autorizuar,

_____ lindur më _____ ne _____ dhe banues në _____, i pajisur me karte identiteti nr. _____-, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili do të quhet PUNËDHENESI.

DHE

Z./Zj _____ lindur më _____, në _____ – Shqiperi,e pajisur me karte identiteti nr. _____, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili do të quhet PUNËMARRESI.

Baza Ligjore

Ligji nr. 7850, datë 27.09.1994 “ Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr.113/2016 dt.03.11.2016, Ligji nr. 8116 datë 19.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr.114/2016 dt.03.11.2016, Ligji nr. 7961 dt.12.07.1995, “Kodi i Punës” i ndryshuar me ligjin nr.136/2015 dt.05.12.2015, Ligji nr.7703 dt.11.03.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.144/2015 dt.17.12.2015 si dhe me ligjin nr.25/2017 dt.25.01.2017. Ligji nr.9136 dt.11.09.2003 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te Sigurimeve Shoqërore dhe Shendetesore ne R.SH”, te ndryshuar me ligjin nr.143/2015 dt.17.12.2015 si dhe me ligjin nr.25/2017 dt.25.01.2017. Ligji nr. 69/2012 date 21.06.2012 “Per Sistemin Arsimor Para universitar ne Republiken e Shqiperise” te ndryshuar me ligjin nr.56/2015.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale”



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Punonjësi merret në punë nga **Komisioni Kombëtar për Edukimin Katolik Shqiptar** me tërësinë e kushteve në vazhdim:

Neni 1

Pershkrimi i Punës

Punëmarresi do të jetë në pozicionin e _____ të Komisionit Kombëtar për Edukimin Katolik Shqiptar. _____ merret me _____ që nevojiten për veprimtarinë e KKEKSH. _____

Neni 2

Te drejtat dhe detyrimet e Punëmarresit

- Punëmarresi do të kryejë me korrektësi punën sipas profilit të kualifikimit të tij.
- Punëmarresi do të ndjekë me korrektësi, rigorozitet dhe përpikmëri rregullat e instruktimit teknik të përcaktuara nga Kodi i Punës dhe nga legjislacioni në fuqi për natyrën e veçantë të punës.
- Punëmarresi do të kontrollojë dhe ndjekë me vëmendje të gjithë proceset e punës si dhe do të mbikqyrë punën e punonjësve të tjerë.
- Punëmarresi do të mbikqyrë dhe mbajë përgjegjësi për mbrojtjen e punëtorëve, për sigurimin e jetës dhe shëndetit të tyre, si dhe për zbatimin nga ana e tyre të rregullave të instruktimit teknik.
- Punëmarresi do të respektojë dhe zbatojë urdhërat e udhëzimet e punëdhënësit. Kur lind nevoja, punëmarresi duhet të njoftojë punëdhënësin për rrezikun e mundshëm të një procesi të caktuar, si dhe për rrezikun që mund të vijë nga zbatimi i një urdhëri apo udhëzimi të punëdhënësit, duke dhënë shkaqet dhe arsyet me argumente profesionale.
- Punëmarresi do të kujdeset dhe përgjigjet përpara punëdhënësit për mirëmbajtjen e vendit të punës, si dhe të mjeteve të punës që përdoren gjatë proceseve të ndryshme.
- Punëmarresi do të informojë punëdhënësin për proceset e punës si dhe do të njoftojë atë për mekanizmat, makineritë dhe pajisjet teknologjike përse i përket çdo defekti, mirëmbajtje rutinë, apo rreziku që ato mund të shfaqin.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Për Mbrojtjen e të Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Neni 3

Detyrimet e punëdhënësit

- Te japë pagën e përcaktuar në kontratë.
- Punëdhënësi do t'i japë punën në dorëzim punëmarrësit që nga dita e nesërme e lidhjes së kësaj kontrate.
- Punëdhënësi do të instruktojë punëmarrësin dhe japë të gjitha informacionet e duhura për proceset e punës dhe rrezikun e tyre.
- Punëdhënësi do të sigurojë punëmarrësin dhe derdhë kontributet në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.
- Punëdhënësi do të sigurojë kushte optimale pune për punëmarrësin dhe do ta furnizojë atë me materiale pune, si dhe do ta njoftojë atë për çdo problem apo rrezik të mundshëm.
- Punëdhënësi do të kontaktojë në çdo moment me punëmarrësin për çdo shqetësim që ka të bëjë me punën.
- Punëdhënësi do të kujdeset që makineritë, mjetet dhe mekanizmat e punës të jenë funksionalë, të sigurtë gjatë përdorimit, si dhe do të marrë masa që të jenë periodikisht të kontrolluara nga ana teknike.
- Punëdhënësi do të marrë masa për të parandaluar zjarre apo shpërthime të mundshme të lëndëve që mund të shpërthejnë.
- Punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e pushimeve sipas legjislacionit në fuqi.
- Të shqyrtojë kërkesat eventuale të punëmarrësit në përputhje me dispozitat ligjore
- Të nxjerrë rregulloren e brendshme të punës.

Neni 4

Kohëzgjatja e kontratës.

Kjo kontratë lidhet për një periudhë kohe _____ Zbatimi i kontratës fillon më _____ dhe është e vlefshme deri më _____
 Që nga periodha që kjo kontrate hyn ne fuqi, çdo marrëveshje tjetër e mëparshme anulohet.

Neni 5

Periudha e proves

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Tre muaj nga marrja në punë. Nëse punëdhënësi nuk shprehet për ndërprerjen e kontratës, kontrata quhet e lidhur. (per punonjesit që merren per here te pare ne pune).

Neni 6

Mënyra e pagesës

Paga shprehet ne lek dhe paguhet nepermjet bankes një herë në muaj brenda dates te muajit pasardhes, te vertetuar sipas listeprezencës në punë.

Neni 6

Paga dhe Ndalesat

- Paga bruto do të jetë _____ lekë në muaj. Mbi pagën bruto do të bëhen ndalesat për sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe Tatimi mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi.
-
- Sigurimet shoqërore.

Punëdhënësi, në bazë të ligjit Nr.7703 11.05.1993 “Per sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar, detyrohet të derdhë në favor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore kontributin e sigurimeve për çdo punëmarrës, me qëllim që punëmarrësit në rastet e sëmundjeve, të aksidenteve, të lejeve të barrëlindjeve apo të pleqërisë, të kenë mundësinë të përballojnë paaftësinë e përkohshme ose të përfitojnë pensionin mbas përfundimit të moshës së aftë për punë. Punëmarrësit do t’i mbahet kuota prej 11.2% nga paga dhe punëdhënësi ka në ngarkim të tij kuotën prej 16.7% të pagës bruto të punëmarrësit. Ndryshimet eventuale të përqindjeve, në harkun kohor të një viti, nga ana e Shtetit, për derdhjen e kontributeve dhe tatimeve, do të aplikohen sipas dispozitave në fuqi.

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale”



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Neni 7

Kohëzgjatja e punës

Punëmarrësi do të punojë pranë (KKEKSH) Komisionit Kombëtar për Edukimin Katolik Shqiptar nga dita e Hënë deri ditën e Premte për ___ore në ditë, ___ore javore. Ora e fillimit dhe mbarimit të punës përcaktohet në rregullore të brendshme.

Neni 8

Pushimet vjetore

Punëmarrësi ka të drejtën e dy ditë pushime në javë, dhe të pushimeve në ditët e festave zyrtare sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Shkeljet disiplinore

Si rregull, konsiderohen shkelje disiplinore:

1. mosrespektimi i pajustificuar i orarit të punës;
2. mosrespektimi i pajustificuar i kohës së punës;
3. moskryerja e detyrave apo kryerja e pjesshme e tyre pa shkak të arsyeshëm;
4. mosplotesimi dhe/ose perditesimi i te dhenave dhe/ose dokumenteve të kerkuara për t'u perfshire ne dosjen personale të punemarresit.
5. kryerja, brenda apo jashtë kohës së punës, e veprimeve, që ulin ose çënojnë imazhin e vendit ku punon.

Neni 10

Zgjidhja e kontratës

Zgjidhja me paralajmerim e kontrates punes behet sipas kushteve ne respektim te afatit te njoftimit ne rastet e parashikuara me poshte :

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Për Mbrojtjen e te Dhenave Personale"



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

- te shfaqjes se paaftësisë profesionale nga punemarresi;
- te performances te pamjaftueshme dhe/ose jo te duhur ne ushrimin e detyres nga ana e punemarresit;
- Shkurtim i vendit te punës.
- Kryerje e veprimeve ose mos veprimeve ne kundershtim me kontraten e punes, dhe rregulloren e Komisionit per Edukimin Katolik Shqiptar.
- Shkelje te dispozitave ligjore qe rregullojne marrëdhëniet e punës.
- Shkelje te etikes sjelljes ne institucion.
- Lënie e pajustificuar e vendit të punës.
- Mungesa të përsëritura në punë, duke shfaqur justifikime të pa arsyeshme, ku dëmtohet aktiviteti që kryen punëdhënësi.
- Kur nuk ruan konfidencialitetin

Zgjidhja e menjehershme e kontrates punes:

- Shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë.
- Vepron ne menyre te perseritur ne kundershtim me kontraten e punes dhe rregulloren e brendshme.
- Në rast se ndryshojnë kushtet thelbësore të kontratës, secila nga palët mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës përpara afatit, të tilla që e bëjnë të pazbatueshme kontratën.
- Punëdhënësi ka të drejtë të ndëshkojë punëmarrësin për shkelje të disiplinës apo \ thyerje të kushteve të rregullores së punës duke e njoftuar më parë atë për shkeljen dhe duke i dhënë mundësinë të shpjegohet.

Neni 11

Zgjidhja e kontrates

Per zgjidhjen e kontrates se punes palet duhet te respektojne nje afat kohor njoftuar me shkrim, perkatesisht:

- Një muaj për të punësuarit që kanë mbi 6-muaj deri ne dy vjet pune.
- Dy muaj për të punësuarit që kanë dy deri në pesë vjet punë.
- Tre muaj për të punësuarit që kanë më shumë se 5 vjet punë

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale”



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK SHQIPTAR

Neni 12

Dispozita te tjera

Për sa nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kodi i Punës në fuqi, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës dhe Rregullorja e brendshme e Komisionit Kombëtar për Edukimin Katolik Shqiptar.

Nëse lindin mosmarreveshje ndërmjet palëve, ato do të zgjidhen duke zbatuar parimin e mirëkuptimit. Nëse një gjë e tillë nuk arrihet, kompetente për këtë do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim.

Kjo kontratë lexohet nga të dy palët dhe firmoset prej tyre me vullnet të lirë e të plotë. Kjo kontratë përbëhet nga pese faqe dhe mbyllet me nenin 12. Kontrata përpilohet në dy kopje, një kopje e kontratës i lihet punëmarrësit dhe një kopje i lihet punëdhënësit.

PUNËMARRËSI

PUNËDHËNËSI

¹ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Për Mbrojtjen e te Dhenave Personale"